

AKT THEMELIMI I DOAR 30 SHPK

Sot me date 04.04.2022, une e nenshkruara : Znj.Dorela Stafa E bija e Asim Stafa, lindur ne Burrel dhe banuese ne Tirane, shpreh vullnetin per hartimin e ketij Akti Themelimi te Shoqerise **DOAR 30 SHPK** si me poshte vijon:

1. FORMA LIGJORE “ SHPK”, eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

2. ORTAK I VETEM THEMELUES Ortak vetem, themelues i shoqerise eshte Znj. **Dorela Stafa**

3. OBJEKTI Objekti i veprimtarise te shoqerise **DOAR 30 SHPK** eshte:

- **Ushtrim i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit financiar jo-banke AK-INVEST sh.a.**
- **Agjenci udhetimi**

4. SELIA

Selia e shoqerise tregtare **DOAR 30 SHPK** do te jete ne adresen: Tirane, Rr. Myslym Keta, Nd. 7, Nr. ap. 2

5. KOHEZGJATJA

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe kohore te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar. Afati i permendur ne piken 1 te ketij neni mund te shkurtohet apo zgjatet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga Statuti i Shoqerise.

6. KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare **DOAR 30 SHPK** eshte 2.500.000 Leke (dy milion e peseqind mije leke). Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 kuote dhe vlere nominale e nje kuote eshte 2.500.000 Leke (dy milion e peseqind mije lek). Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjitha kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te tyre. Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere. Cdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

7. ORTAKU I VETEM

Ortaku i Vetem ushtron kompetencat qe ligji i jep Asamblese se Ortakeve.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administrator i pare i shoqerise
DOAR 30 SHPK eshte Z .Ardit Karasani

9. SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI

Shperberja dhe likuidimi i shoqerise tregtare mund te vije ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku ligjor, duke perfshire dhe falimentimin, privimin per te ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe te cdo faktori tjeter qe nuk varet nga vullneti i ortakeve te shoqerise.

Themeluesi

Znj. Dorela Stafa

Dorela Stafa
